 <p><b>DAV</b> Drejtoria e Akreditimit</p> <p>Tel: 362566 Fax: 364608 E-Mail: info@albanianaccreditation.gov.al</p>	<p><b>Rekrutimi, rregjistrimi, mirëmbajtja dhe selektimi i vlerësuesve të Drejtorisë Akreditimit.</b></p>	<p><i>Kodi DA-PM-002</i></p> <hr/> <p><i>Rishikim nr 0</i> <i>Dt ____/____/____</i></p> <hr/> <p><i>Faqe 1 deri 9</i></p>
--	---	---


## Rekrutimi, rregjistrimi, mirëmbajtja dhe selektimi i vlerësuesve të Drejtorisë së Akreditimit.

Zbatues: Drejtori i Përgjithshëm, Menaxheri i Cilësisë, Përgjegjësi i Sektorit të Personelit Burimeve Financiare, Drejtori i Departamentit të Zhvillimit, Drejtori i Departamentit të akreditimit, Vlerësuesit.

Përgjegjës për zbatimin: Përgjegjësi i Sektorit të Personelit.

Kontrolloi: Ardita Fuga

Miratoi: Agim Anxhaku

 <p><b>DA</b> Drejtoria e Akreditimit</p> <p>Tel: 362566 Fax: 364608 E-Mail: info@albanianaccreditation.gov.al</p>	<p><b>Rekrutimi, rregjistrimi, mirëmbajtja dhe selektimi i vlerësuesve të Drejtorisë Akreditimit.</b></p>	<p><i>Kodi DA-PM-002</i></p> <hr/> <p><i>Rishikim nr 0</i> <i>Dt ____/____/____</i></p> <hr/> <p><i>Faqe 2 deri 9</i></p>
---	---	---

## 1. QELLIMI

Procedura ka për qëllim të:

- a) Përcaktojë kërkesat për rekrutimin e vlerësuesve që do të ngarkohen nga DA për të kryer vlerësimin e OVK-ve.
- b) Përshkruajë kriteret dhe modalitet operative për rregjistrimin, mbikqyrjen dhe selektimin e vlerësuesve të Drejtorisë së Akreditimit.
- c) Të përcaktoje metodat për kontrollin e vlerësuesve gjatë aktivitetit të vlerësimit.

## 2. FUSHA E ZBATIMIT

Kjo procedurë zbatohet për rekrutimin, seleksionimin, rregjistrimin dhe mirëmbajtjen e vlerësuesve të Drejtorisë së Akreditimit.


### 3.0 PERGJEGJËSITË

Kjo procedurë zbatohet nga Drejtori i Përgjithshëm, Menaxheri i Cilësisë, Përgjegjësi i Sektorit të Personelit dhe burimeve financiare, si edhe nga Vlerësuesit që do të aktivizohen nga DA. Kontrolli i Vlerësuesve të rregjistruar në listë kryhet nga Menaxheri i Cilësisë.

### 4.0 REFERIMET

<b>4.1S SH ISO/IEC 17011:2003</b>	Kërkesa të përgjithshme për organizmat akreditues që kryejnë akreditimin e organizmave të vlerësimit të Konformitetit
<b>4.2 ISO/IEC 17000</b>	Vlerësimi i Konformitetit. Fjalori dhe Parimet e Përgjithshme.
<b>4.3 S SH EN ISO 19011</b>	Udhëzues për Kontrollin e Sistemeve të Menaxhimit të Cilësisë dhe/ose të Menaxhimit Mjedisor
<b>4.4 S SH ISO 9000:2000</b>	Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë
<b>4.5 EN 45020</b>	Standardizim dhe veprimtari që lidhen me të. Fjalori i Përgjithshëm ISO/IEC Udhëzues 2:19

### 5.0 FJALORI DHE SHKURTIME

 <p><b>Drejtoria e Akreditimit</b></p> <p>Tel: 362566 Fax: 364608 E-Mail: info@albanianaccreditation.gov.al</p>	<b>Rekrutimi, rregjistrimi, mirëmbajtja dhe selektimi i vlerësuesve të Drejtorisë Akreditimit.</b>	<b>Kodi DA-PM-002</b>
		Rishikim nr 0 Dt ____/____/____
		Faqe 3 deri 9

Në këtë procedurë është përdorur terminologjia e standardit ISO 17011, shkurtimet janë sipas listës që i është bashkëngjitur Manualit të Cilësisë DA-MC-001 si edhe :  
Vlerësues: Kryevlerësues, Ekspert.

## 6.0. KERKESAT E VLERESUESVE


Vlerësuesit që të jenë të përfshirë në listë duhet të plotësojnë disa kërkesa minimale në lidhje me arsimin e nevojshëm, vitet e eksperiencës në një ose më shumë sektorë të specifikuar brenda fushës ku janë kërkuar.

### 6.1 Kriteretë të përgjithshme

- 1-Të njohë rregullat përkatëse ligjore, procedurat e akreditimit si dhe kërkesat e akreditimit
- 2- Të jenë të lirë nga çdo lloj presioni tregtar, financim të natyrave të tjera, ose nga konflikt interesash, të cilat mund ti shtyjnë të veprojnë në mënyrë të njeanshme ose diskriminuese.
- 3-Të mos kete ofruar konsultime gjatë 3 viteve te fundit, për organizmin që do të vlerësojë gjë që mund të kompromentoje paaanëshmërinë tyre në procesin e akreditimit.

## 7.0 Minimumim i kriterëve për kryevlerësuesin, vlerësuesit dhe aftësia e ekspertëve.


	Parametrat	Vlerësuesit	Vlerësues në dy ose më shumë fusha	Kryevlerësuesi	Ekspert
1	Kualifikimi	Arsimi i larte	E njëjtë për vlerësuesit	Universitete/Institute	Shkolla mesme
2	Eksperienca në punë( Vjetërsia në total)	5 vjet	5 vjet	5 vjet	5 vjet
3	Eksperienca në fushën e menaxhimit të cilësisë dhe/ose të mjedisit	Eksperienca në fushën përkatëse, jo më pak se 2 vjet dhe në total 5 vjet.	2 vjet në fushat e tjera	3 vjet	_____
4	Tranim për Vlerësuesit	40 orë vlerësimi,	+ 16 orë në fushën e dytë	+16 orë tranim kryevlerësues.	_____

 <b>Drejtoria e Akreditimit</b> Tel: 362566 Fax: 364608 E-Mail: <a href="mailto:info@albanianaccreditation.gov.al">info@albanianaccreditation.gov.al</a>		<b>Rekrutimi, rregjistrimi, mirëmbajtja dhe          selektimi i vlerësuesve të Drejtorisë          Akreditimit.</b>			<b>Kodi DA-PM-002</b>
					Rishikim nr 0 Dt ____/____/____
					Faqe 4 deri 9
		trainimi në fushat përkatëse të standardeve për akreditimi			
5	Eksperiencia ne Vlerësim	4 vlerësime të plota të paktën 20 ditë eksperiencë vlerësimi si vlerësues nën trainimin dhe udhëheqjen direkte të një vlerësuesi me kompetencë në vlerësim sic është kryevlerësuesi.	3 vlerësime të plota të paktën 15 ditë eksperiencë vlerësimi si vlerësues nën trainimin dhe udhëheqjen direkte të një vlerësuesi me kompetencë në vlerësim sic është kryevlerësuesi.	3 vlerësime të plota të paktën 15 ditë eksperiencë vlerësimi si vlerësues nën trainimin dhe udhëheqjen direkte të një vlerësuesi me kompetencë në vlerësim sic është kryevlerësuesi	
6	Cilësite personale	Të jetë i hapur në mendim, të ketë etik,diplomatik, i mprehtë, vëshgues, i shkathët, këmbëngulës, i vendosur, i vetëdijshëm	E njëjtë	E njëjtë	E njëjtë
7	Aftësitë menaxhuese			Të zotërojë aftësitë e një drejtuesi të ekipit, aftësinë e përdorimit efektive të aftësive të vlerësuesve, aftësinë për të marrë vendime.	E njëjtë

## 8.0 Karakteristikat Personale te Vlerësuesve

Një vlerësues duhet :

- a. Të respektojë parimet etike, të jetë i drejtë, i vërtetë, i sinqertë, i ndershëm dhe i rezervuar

 <p><b>DA</b> Drejtoria e Akreditimit</p> <p>Tel: 362566 Fax: 364608 E-Mail: info@albanianaccreditation.gov.al</p>	<p><b>Rekrutimi, rregjistrimi, mirëmbajtja dhe selektimi i vlerësuesve të Drejtorisë Akreditimit.</b></p>	<p><b>Kodi DA-PM-002</b></p> <p>Rishikim nr 0 Dt ____/____/____</p> <p>Faqe 5 deri 9</p>
---	---	--

- b. Të ketë mentalitet të hapur, d.m.th të jetë gati të marrë në konsideratë ide apo pikëpamje alternative.
- c. Të jetë diplomat, d.m.th të ketë takt në marrëdhënie me njerëzit
- d. Të ketë shpirt vëshgues, d.m.th të jetë vashdimisht i ndërgjegjshëm për aktivitetin dhe ambientin që e rrethon

## 9 REKRUTIMI

### 9.1 Verifikimi dhe aprovimi

Vlerësuesi i cili kërkon të bashkëpunojë me DA duhet të plotësojë një formular ( DA-FO - 045) bashkëngjitur CV, si dhe dokumenta të tjera justifikues që të vërtetojë plotësimin e kriterëve të përcaktuara në pikën 7.0 .Të gjitha këto do t'i dorëzojë në sektorin e Personelit dhe burimeve financiare në Drejtorinë e Akreditimit.

Përgjegjësi i sektorit të personelit dhe burimeve financiare si dhe drejtori i departamentit të zhvillimit pasi kryejnë verifikimin në përputhje me kërkesat e pikës 6.0 dhe 7.0, si dhe pasi marrin aprovimin nga Drejtori i Përgjithshëm i DA përgatisin nje dosje specifike.

Pas aprovimit vlerësuesi nënshkruan një kontratë me DA ( DA-FO-037) n.p.m së cilës angazhohen se do të respektojnë të gjitha rregullat dhe detyrimet që përcaktohen në këtë kontratë.


## 10 Lista e Vlerësuesve

Specialisti i Drejtorisë së Zhvillimit parapërgatit tre lista të vlerësuesve të nëndara:

- a) Lista e vlerësuesve të sistemit
- b) Lista e vlerësuesve teknikë.
- c) Lista e vëshguesve

## 11 FSHEHTESIA

Vlerësuesit të cilët përfshihen në listë, thirren më parë nga DA të firmosin një deklaratë konfidencialiteti, (DA-FO 010), se i gjithë informacioni i marrë gjatë aktivitetit vlerësues do të mbahet në fshehtësi rigorozë. Kjo deklaratë do të nënshkruhet nga vlerësuesit sa herë të aktivizohen nga DA. Një kopje e deklaratës së konfidencialitetit i

 <p><b>Drejtoria e Akreditimit</b></p> <p>Tel: 362566  Fax: 364608  E-Mail:  info@albanianaccreditation.gov.al</p>	<b>Rekrutimi, rregjistrimi, mirëmbajtja dhe  selektimi i vlerësuesve të Drejtorisë  Akreditimit.</b>	<b>Kodi DA-PM-002</b>  Rishikim nr 0 Dt ____/____/____  Faqe 6 deri 9
---	--	--

bashkengjitet kësaj procedure dhe një kopje tjetër dosjes se vlerësuesit dhe ruhet në arkivin pranë Drejtorise se Akreditimit

## 12. SELEKSIONIMI

Për rastet e aplikimeve për akreditim, është përgjegjësi e Drejtorit të Departamentit të Akreditimit të selektoj vlerësuesit nga lista e përgatitur. Selektimi bazohet në njohuritë e vlerësuesit për fushën e akreditimit dhe eksperiencën e tij. Në rastet kur procesi i akreditimit është delikat atëherë zgjidhet ai vlerësues i cili ka eksperiencën më të madhe dhe në monitorimet që janë bërë ka dhënë rezultate të kënaqshme. Për seleksionimin midis dy vlerësuesve të njëjtë drejtori i departamentit merr parasysh edhe gadishmërinë e tyre dhe realizimin sa më të shpejtë të vlerësimit të OVK.

## 13.MIRËMBAJTJA

Brenda një periudhe 1 vjecare DA i kërkon vlerësuesve të azhurnojnë dosjet e tyre.


Spektori i personelit dhe burimeve financiare azhurnon dosjen e vlerësuesve. Përgjegjësi i sektorit të personelit dhe burimeve financiare verifikon CV, azhurnon dhe përgatit një relacion për Drejtorin e Përgjithshëm të DA i cili jep gjykimin e tij mbi mirëmbajtjen e listës së vlerësuesve .

Pasi merret aprovimi i Drejtorit të Përgjithshëm të DA, Specialisti i Drejtorisë së Zhvillimit azhurnon listën e vlerësuesve.

## 14. TRAINIMI

Vlerësuesit e përfshirë në listë duhet të marrin pjesë në kurset kualifikuese, të organizuara nga DA, e cila përgatit një plan vjetor të trainimeve ( DA-FO- 046). Ky plan publikohet nga DA në websiten zyrtar, Vlerësuesit e interesuar aplikojnë duke plotësuar formularin ( DA-FO-050). Kjo kërkesë vlerësohet nga Drejtoria e Departamentit të Zhvillimit dhe më pas merret vendimi për pjesëmarrjen ose jo të vlerësuesit në këtë trajnim.

Pas përfundimit të trainimit dhe verifikimit të njohurive të pjesëmarrësve mbi çështjet objekt i trainimit , DA vendos nëse duhet të përfshije apo jo në listen e vlerësuesve. Verifikimi i njohurive kryhet mbi bazën e një pyetsori të përgatitur nga ekspertët që organizojnë trainimin. Vlerësimi ruhet në dosjen personale të vlerësuesit.

 <p><b>DA</b> Drejtoria e Akreditimit</p> <p>Tel: 362566 Fax: 364608 E-Mail: info@albanianaccreditation.gov.al</p>	<p><b>Rekrutimi, rregjistrimi, mirëmbajtja dhe selektimi i vlerësuesve të Drejtorisë Akreditimit.</b></p>	<p><i>Kodi DA-PM-002</i></p> <hr/> <p><i>Rishikim nr 0</i> <i>Dt ____/____/____</i></p> <hr/> <p><i>Faqe 7 deri 9</i></p>
---	---	---

Në rast se do të evidentohen mangësi mbi njohjen e kërkesave, standardeve, dhe procedurave të akreditimit dhe ato teknike, vlerësuesi transferohet në listën e vëshguesve dhe do të rivendoset në listën e vlerësuesve kur të kalojë një kontroll të mëtejshëm të DA dhe të paiset me një dokumentacion që e vendos në një situatë të re. Vlerësuesi njoftohet nga sektori i personelit dhe burimeve financiare të DA për çdo lloj rezultati.

Nje vlerësues i cili brenda një viti nuk merr pjesë për 3 herë rresht në të paktën një prej kurseve trainuese të organizuara nga DA nuk do të ngarkohet për të kryer vlerësime deri sa ta marrë pjesë një trainimin pasues.

DA përgatit një certifikatë për pjesëmarrjen dhe vlerësimin në trainim dhe ia bashkëngjit këtë dosje personale të vlerësuesit

### **15 Monitorimi i aktiviteteve të zhvilluara nga vlerësuesit.**

Në fund të kontrolleve të kapacitetit, njohjet, zhvillimit të vizitave korrekte, DA të paktën 1 herë në 3 vjet zhvillon këto aktivitete mbikqyrëse .


- a) Shqyrtimi i dokumentave
- b) Vlerësimi ne vend

#### **15.1 Shqyrtimi i dokumentave**

Shqyrtimi i dokumentave kryhet nga menaxheri i cilësisë dhe drejtori i departamentit të akreditimit mbi bazen e aktiviteve të zhvilluara nga vlerësuesit (certifikata e trainimit, licensat propozuara nga laboratorët).

#### **15.2 Vlerësimi ne vend**

Vlerësimi në vend kryhet nga një përfaqësues i DA, i ngarkuar të marrë pjesë në një vizitë vlerësuese pranë OVK duke ndjekur veprimet e vlerësuesit gjatë vizitës vlerësuese në OVK. Mangësitë që nxirren duke respektuar ata që janë përcaktuar në dokumentat e DA gjatë kryerjes së aktivitetit nga vlerësuesi rregjistrohen në një raport jo konformiteti, i cili i dërgohet vlerësuesit për të parashtruar rezervat apo propozimet/veprimet korrigjuese. Secili vlerësues do të vlerësohet në vend rregullisht,

 <p>Tel: 362566 Fax: 364608 E-Mail: info@albanianaccreditation.gov.al</p>	<b>Rekrutimi, rregjistrimi, mirëmbajtja dhe selektimi i vlerësuesve të Drejtorisë Akreditimit.</b>	<b>Kodi DA-PM-002</b>
		Rishikim nr 0 Dt ____/____/____
		Faqe 8 deri 9

të paktën një herë në 3 vjet. Për vlerësuesit, për të cilët është parashikuar një program i mëtejshëm trainimi , ose mbikqyrje përfaqësuesi i DA përgatit një raport përkatës në fund të cdo vizite të kryer në përputhje me programin. Raporti i paraqitet Drejtorit të

Përgjithshëm të DA. Gjithashtu vlerësuesit monitorohen nga DA, nga kryevlerësuesi, dhe organizmi i akredituar duke plotësuar formularin (DA-FO-015). Drejtori i Përgjithshëm i DA pasi vlerëson rezultatet e aktiviteteve merr një nga vendimet e mëposhtme:

- a-Të përgatisë një program të mëtejshëm trainimi apo vlerësimi
- b- Të ftojë vlerësuesin të diskutojë rreth programit
- d- Të pezullojë vlerësuesin për një kohë të pacaktuar, ta heqë nga lista e vlerësuesve të DA .

15.3- Nëse vlerësuesi nuk është angazhuar për më shumë se 3 vjet, ose nuk ka marrë pjesë në trainime, Drejtori i Përgjithshëm i DA vendos të fshijë vlerësuesin nga lista e DA


## 16. Rregjistrimi

Sektori i Personelit dhe burimeve financiare disponon një dosje për cdo vlerësues në të cilën është e arkivuar

- a) Formulari i Aplikimit (DA-FO-045);
- b) Curriculum -Vitae;
- c) Monitorimi përkatës i vlerësuesve (DA-FO 015);
- d) Certifikatat e pjesëmarrjes në kurse si të organizuara nga DA, apo të ndonjë kursi tjetër ekuivalent të njohur nga DA
- e) Deklarata e Konfidencialitetit (DA-FO- 010)
- f) Kontrata midis DA dhe vlerësuesit (DA-FO-038)

## 17. RREGJISTRIME QË DALIN NGA KJO PROCEDURË

Titulli i dokumentit	Kush e plotëson	Kur e plotëson	Kush e ruan
Formulari i Aplikimit (DA-FO-045)	Vlerësuesi	Kur aplikon	Sekt. i Personelit
Format e Monitorimit (DA-FO-015)	DA Organizmi i Akredituar	Pas përfundimit të vizitës vlerësuese.	Sek. Personelit

 <b>Drejtoria e Akreditimit</b> Tel: 362566 Fax: 364608 E-Mail: info@albanianaccreditation.gov.al	<b>Rekrutimi, rregjistrimi, mirëmbajtja dhe          selektimi i vlerësuesve të Drejtorisë          Akreditimit.</b>			<b>Kodi DA-PM-002</b>
				Rishikim nr 0 Dt ____/____/____
				Faqe 9 deri 9
	Kryevlerësuesi			
Deklarata e Konfidencialitetit (DA-FO- 010)	Vlerësuesi	Para se të përfshihen në aktivitet	Drejtori i departamentit të akreditimit	
Plani Vjetor i Trainimeve (DA-FO-046)	Menaxheri i Cilësisë.	Fillim viti	Drejtoria e Zhvillimit	
Kontrata tip me vlerësuesit( DA-FO-037)	Vlerësuesi.	Pas aprovimit nga Drejtori i Përgjithshëm	Sekt. Personelit	

## 18. HISTORIKU

Data e ripunimit	Numri i rishikimit	Hartoi	Përshkrimi i ndryshimeve
30.10.2006	0	Majlinda Xhema	

**Rekrutimi, rregjistrimi, mirëmbajtja dhe  
selektimi i vlerësuesve të Drejtorisë  
Akreditimit.**

Kodi DA-PM-002

Rishikim nr 0

Dt \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_

Faqe 10 deri 9

